



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 57, datë 24 .12. 2012

**PËR
“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË
TIRANË DHE INSTRUMENTAVE VENDORE TË PLANIFIKIMIT, PJESË
PËRBËRËSE E TIJ.”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 10, pika 3/I gërma “g” dhe nenit 32 të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Kreut IV, Seksionit II, nenit 44 dhe 89 të ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 për “Planifikimin e territorit” (i ndryshuar) si dhe nenit 16, 20, 24 dhe 26 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.481, datë 22.06.2011 për “Miratimin e rregullores uniformë të instrumentave të planifikimit”, në vijim të VKB nr.18 datë 10.11.2011 “Për miratimin e nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I:

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë dhe instrumentave vendore të planifikimit, pjesë përbërëse e tij.
2. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë, instrumentat vendore të planifikimit, pjesë përbërëse e tij, si dhe vendimi i miratimit nga Këshilli Bashkiak, t’i dërgohen brenda 15 ditëve nga data e miratimit, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, për miratim përfundimtar nga Këshilli Kombëtar i Planifikimit të Territorit.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Investimeve të Huaja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI